Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 1 shkurt 2013

Lënda nr. 52/09

B. A.

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 1 shkurt 2013,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve gjeti dhe rekomandoi si vijon:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua më 17 prill 2009 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

2. Më 12 qershor 2009, Paneli kërkoi informacione plotësuese nga ankuesi. Ankuesi ju përgjigj kësaj kërkese më 18 shtator 2009.

3. Më 2 nëntor 2009, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)[1] për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e rastit. Më 21 janar 2010, PSSP-ja e dha përgjigjen e UNMIK-ut.

4. Më 21 korrik 2010, Paneli ja dërgoi përgjigjen e UNMIK-ut ankuesit. Ankuesi ofroi përgjigjen e tij më 7 shtator 2010.

5. Më 6 tetor 2010, Paneli ia dërgoi përgjigjen e ankuesit PSSP-së. Më 18 tetor 2010, PSSP-ja e dha përgjigjen e UNMIK-ut.

6. Më 21 tetor 2010, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

7. Më 27 tetor 2010, Paneli ia komunikoi vendimin për pranueshmërinë PSSP-së, duke ftuar UNMIK-un që japë vërejtjet e tij për bazueshmërinë e rastit. Më 2 nëntor 2010, PSSP-ja e dha përgjigje e UNMIK-ut.

8. Më 18 gusht 2011, Paneli kërkoi nga UNMIK-u dosjet e hetimeve. Më 6 shtator 2011, UNMIK-u ju përgjigj kërkesës. Paneli e përsëriti kërkesën e tij më 2 tetor 2012. UNMIK-u u përgjigj më 9 nëntor 2012.

I. FAKTET

A. Historiku i përgjithshëm [2]

9. Ngjarjet në fjalë ndodhën në territorin e Kosovës pas vendosjes së Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në qershor të viti 1999.

   Konflikti i armatosur gjatë 1998 dhe 1999 në mes të forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të

---

[1] Një listë e shkurtimeve dhe akronimeve të përfshira në tekst mund të gjendet në Shtojcën e bashkëngjitur.

[2] Referencat që i ka marrë Paneli në paraqitjen e këtij historiku të përgjithshëm përfshijnë: OSBE, "As Seen, as Told", vëllimi 1 (tetor 1998 – qershor 1999) dhe vëllimi II (14 qershor – 31 tetor 1999); raporte tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; Raportet vjetore të Policisë së UNMIK-ut (2000, 2001); Qendra ligjore humanitare, "Rrëmbimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë" (2001); Qendra ligjore humanitare, "Kosovo Memory Book" (htpp://WWW.kosovomemorybook.org); Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, Raport i aktiviteteve 2002-2004; Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Behrami dhe Behrami kundër Francës* dhe *Saramati kundër Francës, Gjermania dhe Norvegjia*, nr. 71412/01 dhe 78166/01, vendim i 2 majit 2007; Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, "Situata në Kosovë: a Stock Taking" (2010); të dhëna të lëshuara nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, (gjinden në WWW.unhchr.org) dhe nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (gjinden në http://familylinks.icrc.org/kosovo/en).

përpjekjeve ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) lajmëroi fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ). Sulmet ajrore filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999 kur RFJ u pajtua që të tërheqë forcat e veta nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ dhe Republika e Serbisë nënshkruan "Marrëveshjen Teknike Ushtarake" me të cilën u pajtuan për tërheqjen e RFJ-së nga Kosova dhe vendosjen e pranisë së Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë që pasoi me një Rezolutë përkatëse të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

10. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit të KB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas kapitullit VII të Kartës së KB-së, Këshilli i Sigurimit të KB-së mori vendim për vendosjen e sigurisë ndërkombëtare dhe pranisë civile – KFOR-it dhe UNMIK-ut – në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999), KB-ja u vesh me pushtet të plotë legjislativ dhe ekzekutiv për administrimin e përkohshëm të Kosovës, duke përfshirë edhe administrimin e drejtësisë. KFOR-i u ngarkua me detyrën e krijimit të një "ambienti të sigurt ku refugjatët dhe personat e zhvendosur të mund të kthehen në shtëpi të sigurt" dhe me detyrën e sigurimit të përkohshëm të "rendit dhe sigurisë publike" derisa prania civile ndërkombëtare të merrte përsipër përgjegjësinë për këtë detyrë. UNMIK-u përbënte katër komponentë apo shtylla kryesore të drejtuara nga Kombet e Bashkuara (administrata civile), Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ndihma humanitare, që u shua në qershor të vitit 2000), OSBE-ja (krijimi i institucioneve) dhe BE-ja (rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik). Çdo shtyllë ishte nën autoritetin e PSSP-së. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 (1999) i dha mandatin UNMIK-ut të "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut.

11. Vlerësimet lidhur me efektin e konfliktit në zhvendosjen e popullatës shqiptare të Kosovës radhiten përafërsisht nga 800,000 deri më 1.45 milion. Pas miratimit të Rezolutës 1244 (1999), shumica e shqiptarëve të Kosovës të cilët ishin larguar, apo dhunshëm ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe gjatë konfliktit, u kthyen në Kosovë.

12. Në ndërkohë, pjesëtarët e komunitetit joshqiptarë – kryesisht por jo ekskluzivisht serb, rom dhe mysliman sllav– si dhe shqiptarë të Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritete serbe, u bënë shënjestër të sulmeve anembanë nga grupet e armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimet aktuale lidhur me numrin e serbëve të zhvendosur të Kosovës janë nga 200,000 deri më 210,000. Derisa shumica e serbëve të Kosovës dhe të tjerëve joshqiptarë shkuan në Serbi dhe në shtetet fqinje, ata që mbetën u bënë viktima të vrasjeve sistematike, rrëmbimeve, ndalimeve arbitrare, dhunës seksuale dhe gjinore, rrahjeve dhe kërcënimeve.

13. Edhe pse shifrat mbesin të kontestueshme, vlerësohet se më shumë se 15,000 vdekje apo zhdukje ndodhën gjatë dhe menjëherë pas konfliktit në Kosovë (1998-2000). Më shumë se 3,000 shqiptarë etnik, dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera pakicë u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Më shumë se gjysma e personave të zhdukur u gjetën dhe mbetjet e tyre mortore u identifikuan deri në fund

të 2010, kurse 1,766 persona akoma janë të shënuar si të zhdukur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) deri më tetor 2012.

14. Nga korriku 1999, si pjesë e përpjekjeve për të vendosur zbatimin e ligjit në Kosovë në kuadër të kornizës për sundimin e ligjit, PSSP-ja kërkoi nga shtetet anëtare të KB-të mbështesin vendosjen e personelit policor ndërkombëtar prej 4,718 pjesëtarësh në kuadër të komponentës civile të UNMIK-ut. Policia e UNMIK-ut u ngarkuan me detyrën e këshillimit të KFOR-it për çështje policore derisa ata të kishin numrat e mjaftueshëm për të marrë përgjegjësinë e plotë për zbatimin e ligjit dhe të punojnë në drejtim të zhvillimit të shërbimit policor të Kosovës. Në shtator të vitit 1999, UNMIK-ut ju kishin caktuar rreth 1,100 polic ndërkombëtarë.

15. Në dhjetor 2000, pozicionimi i Policisë së UNMIK-ut pothuajse ishte kompletuar me 4,400 pjesëtarë të personelit nga 53 shtete të ndryshme, dhe UNMIK-u kishte parësinë në përgjegjësinë e zbatimit të ligjit në të gjitha rajonet e Kosovës përveç Mitrovicës. Sipas raportit vjetor të Policisë së UNMIK-ut të vitit 2000, atyre u ishin raportuar 351 kidnapime, 675 vrasje dhe 115 dhunime në periudhën ndërmjet qershorit 1999 dhe dhjetorit 2000.

16. Për shkak të rrënimit të administrimit të drejtësisë në Kosovë, UNMIK-u themeloi sistemin emergjent të drejtësisë në qershor të vitit 1999. Ky sistem ishte i përbërë nga një numër i kufizuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë, dhe ishte operacional derisa sistemi i rregullt gjyqësor u bë operativ në janar të vitit 2000. Në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi emërtimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në rajonin e Mitrovicës dhe më vonë në mbarë Kosovën, për të përforcuar sistemin vendor të drejtësisë dhe për të garantuar paanshmërinë e tij. Nga tetori i vitit 2002, sistemi vendor i drejtësisë përbëhej nga 341 gjyqtarë dhe prokurorë vendorë dhe 24 gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Në janar të vitit 2003, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, duke raportuar pranë Këshillit të Sigurimit mbi implementimin e Rezolutës 1244 (1999), e përkufizoi sistemin e policisë dhe të drejtësisë në Kosovë në atë moment si sistem që "funksiononte mirë" dhe ishte "i qëndrueshëm".

17. Në korrik të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit se UNMIK-u tanimë e kishte trajtuar çështjen e personave të zhdukur si një shqetësim veçanërisht të thekshëm të të drejtave të njeriut në Kosovë. Në nëntor të vitit 1999, në kuadër të Policisë së UNMIK-ut u themelua një njësi për persona të zhdukur (NJPZH), e mandatuar për të hetuar qoftë lokacionin e personave të zhdukur dhe/ose vendndodhja e varrezave. NJPZH, së bashku me Njësinë qendrore për hetime penale (NJQHP) të Policisë së UNMIK-ut, dhe më vonë një Njësi e dedikuar për hetimin e krimeve të luftës (NJHKL), ishin përgjegjëse për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. Në maj të vitit 2000, u krijua Komisioni për gjetjen dhe identifikimin e viktimave (KGJIV) i kryesuar nga UNMIK-u, për gjetjen, identifikimin dhe dorëzimin e mbetjeve mortore. Nga qershori i vitit 2002, Zyra e porsaformuar për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u bë autoriteti i vetëm i mandatar për të gjetur vendndodhjen e personave të zhdukur, për të identifikuar mbetjet e tyre mortore dhe për t'ua kthyer ato familjeve të personave të zhdukur. Duk filluar nga 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) në mes të UNMIK-ut dhe

Komisionit ndërkombëtar për persona të zhdukur me bazë në Sarajevë (KNPZH), e plotësuar me një marrëveshje tjetër në vitin 2003, identifikimi i mbetjeve mortore bëhej nga KNPZH përmes testit të ADN-së.

18. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

19. Në të njëjtën ditë, UNMIK-u dhe EULEX-i nënshkruan MM për modalitetet, dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që dilnin nga bartja e rasteve nga UNMIK-u tek EULEX-i, dhe dosjet përkatëse që përfshinin hetimet në vazhdim e sipër, ndjekjet penale dhe aktivitetet tjera të ndërmarra nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Shpejt pas kësaj, u nënshkruan marrëveshje të ngjashme lidhur me dosjet e trajtuara nga gjyqtarët ndërkombëtarë dhe Policia e UNMIK-ut. Të gjitha marrëveshjet e obliguan EULEX-in që UNMIK-ut t'i sigurojë qasje në dokumentacionin që lidhej me veprimet e ndërmarra paraprakisht nga autoritetet e UNMIK-ut. Ndërmjet 9 dhjetorit 2008 dhe 30 marsit 2009, të gjitha dosjet e rasteve penale që mbaheshin nga DD së UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut ju dorëzuan EULEX-it.

B. Rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së z. M.A.

20. Ankuesi është djali i M. A. Ankuesi thekson se më 13 qershor 1999, për shkaqe sigurie, ai u detyrua të largohet nga shtëpia e tij në fshatin Matiçan, rajoni i Prishtinës, ku qëndruan prindërit e tij.

21. Më 26 qershor 1999, babai i tij u zhduk nga shtëpia. Ankuesi thekson se pas zhdukjes ai ishte informuar nga "shqiptarët" se babai i tij ishte vrarë në pronën e tij dhe se ai mund të shkonte ta merrte trupin e tij. Situata e sigurisë ia pamundësi ankuesit që këtë ta bëjë vetëm. Ai kërkoi përcjellje nga KFOR-i, por ata këtë ja refuzuan. Më pas, ai ishte informuar se trupi i babait të tij ishte varrosur në një varr të pashënuar në varrezat e Dragodanit në Prishtinë.

22. Shënimet relevante në bazën e të dhënave të Policisë së UNMIK-ut, që i janë siguruar Panelit nga UNMIK-u, tregojnë se trupi i M.A. ishte zhvarrosur më 10 qershor 2000 nga varrezat e Dragodanit. Sipas certifikatës së vdekjes të lëshuar nga KGJIV më 13 nëntor 2000, vdekja e M.A. ishte shkaktuar nga "tronditje e rëndë në kokë". Ankuesi thekson se pas autopsisë, ai identifikoi rrobat që atij ja kishin treguar dhe konstatoi se i përkasin babait të tij. Më 13 nëntor 2000, me ndihmën e KFOR-it, atij ju kthyen mbetjet mortore të babait dhe më pas u bë varrimi i tyre.

23. Një kopje e certifikatës së vdekjes e lëshuar nga Njësia emergjente mjekësore e spitalit të Prishtinës më 6 qershor 2002, e konfirmon 26 qershorin 1999 si datën e vdekjes, fshatin e Matiçanit si vendin e vdekjes por nuk tregon shkakun e vdekjes.

24. Emri i M.A. është në bazën e të dhënave të grumbulluar nga ZPZHML e UNMIK-ut. Në pjesët relevante të shënimeve për persona të zhdukur në faqen e internetit të ruajtura nga KNPZH [3] lidhur me M.A. thuhet: "janë mbledhur mostra të mjaftueshme relevante" dhe KNPZH i ka siguruar informacione për personin e zhdukur institucionit të autorizuar më 11-27-2005. Për të marrë informacione shtesë, kontaktoni selinë e EULEX-it në Kosovë."

C. Hetimi

25. Përveç materialit të shtypur nga baza e të dhënave të Policisë së UNMIK-ut të cilit ju referuam në § 22 lart, Panelit nuk ju ka prezantuar asnjë material hetimor nga UNMIK-u.

II. ANKESA

26. Ankuesi ankohet për siç pohon dështimin e UNMIK-ut që të hetojë si duhet zhdukjen dhe vdekjen e babait të tij. Në këtë aspekt, Paneli mendon se ai thirret në shkelje të pjesës procedurale të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

27. Ankuesi po ashtu ankohet edhe për dhimbjet dhe vuajtjet mentale që atij dhe familjes i janë shkaktuar nga kjo situatë. Në këtë aspekt, Paneli konsideron se ankuesi mbështetet në nenin 3 të KEDNJ.

III. LIGJI

A. Fushëveprimi i rishqyrtimit nga Paneli

28. Në përcaktimin nëse konsideron se ka pasur shkelje të nenit 2 (pjesës procedurale) dhe nenit 3 të KEDNJ, Paneli është në dijeni për ekzistimin e praktikës gjyqësore, veçanërisht për atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mirëpo, Paneli është po ashtu i vetëdijshëm se ankesat që i parashtrohen ndryshojnë në disa aspekte të rëndësishme nga ato që parashtrohen pranë Gjykatës. Së pari, i padituri nuk është shtet por është një administratë e përkohshme ndërkombëtare territoriale, e mandatuar për ushtrimin e përgjegjësive të përkohshme në Kosovë. Nuk ka asnjë dyshim sa i përket UNMIK-ut lidhur me obligimet themelore sipas nenit 2 të KEDNJ. Së dyti, siç është në një numër të kufizuar të rasteve pranë Gjykatës Evropiane, ata të cilët dyshohet se janë përgjegjës për vrasjet dhe/ose rrëmbimet e pohuara në të gjitha rastet pranë Panelit janë akterë joshtetërorë, shumica e të cilave por jo vetëm janë të lidhur me konfliktin. Këto janë faktorë që Paneli duhet t'i marrë parasysh gjatë vlerësimit për herë të parë të obligimeve pozitive procedurale të një organizate ndërqeveritare lidhur me aktet e kryera nga palët e treta në një territor ku ka kontroll të përkohshëm legjislative, ekzekutiv dhe gjyqësor.

---

[3] Baza e të dhënave gjendet në: http://WWW.ic-mp.org/fdmsËeb/index.php?Ë=mp_details_popup&l=en (qasja e realizuar më 1 shkurt 2013).

29. Para se t'i kthehemi shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të qartësojë fushëveprimin e shqyrtimit të tij.

30. Paneli thekson se me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin e monitorimit të standardeve të pranuara ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut në ushtrimin e funksioneve të tij. Ky obligim u sqarua në detaje në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, me të cilën UNMIK-u mori përsipër obligimet sipas instrumenteve vijuese të të drejtave të njeriut: Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të tjera Mizore, Johumane apo Degraduese dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

31. Paneli po ashtu thekson se neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 e datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, parasheh që Paneli "të shqyrtojë ankesat nga çdo person apo grup i individëve të cilët pohojnë se janë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut të kryer nga UNMIK-u". Për rrjedhojë, vetëm veprimet apo mosveprimet për të cilat ngarkohet UNMIK-u bëjnë pjesë në kuadër të juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Në këtë aspekt, duhet theksuar, siç u cek më lart, se nga 9 dhjetori 2008, UNMIK-u nuk ushtron më pushtet ekzekutiv mbi gjyqësorin e Kosovës dhe mbi mekanizmat për zbatimin e ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk bart përgjegjësi për asnjë shkelje të të drejtave të njeriut që pohohet se është kryer nga këto organe. Për sa i përket ankesë së ankuesit për aktet që ndodhën pas kësaj date, ata janë jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

32. Gjithashtu, Paneli thekson se, sa i përket juridiksionit *ratione materiae*, siç buron nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se mund të shqyrtojë vetëm veprimet apo mosveprimet për të cilat është parashtruar ankesë për përputhshmërinë e tyre me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilave ju referuam lart (shih § 30). Në rastin e caktuar të vrasjeve dhe zhdukjeve në rrethana kërcënuese për jetën, nuk është roli i Panelit të zëvendësojë autoritetet kompetente në hetimin e rastit. Detyra e tij është e kufizuar në shqyrtimin e efektivitetit të hetimit penal për vrasjet dhe zhdukjet e tilla, duke marrë parasysh obligimet procedurale që burojnë nga neni 2 i KEDNJ.

33. Paneli po ashtu thekson se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli ka juridiksion për ankesat që lidhen me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut "që kishin ndodhur jo më herët se 23 prilli 2005 apo që dalin nga faktet që janë paraqitur para kësaj date kur faktet e tilla paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Nga kjo del se ngjarjet që ndodhën para 23 prillit 2005 përgjithësisht janë jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Mirëpo, për aq sa këto ngjarje kanë shkaktuar një situatë që ka vazhduar, Paneli ka juridiksion për të

shqyrtuar ankesat që lidhen me atë situatë (shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Dhoma e Lartë, *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe të tjerë, aktgjykim i 18 shtatorit 2009, §§ 147-149; GJEDNJ, *Qiproja kundër Turqisë [DHL*] nr. 25781/94, aktgjykim i 10 majit 2011, § 136, KEDNJ 2001-IV).

B. Pohimi për shkelje të obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ

34. Paneli konsideron se ankuesi thirret në shkelje të obligimit procedural që buron nga e drejta për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) për shkak se Policia e UNMIK-ut nuk zbatoi hetim efikas për zhdukjen dhe vdekjen e babait të tij.

1. Parashtresat e palëve

35. Ankuesi pohon shkelje për shkak të mungesës së një hetimi penal adekuat për zhdukjen dhe vdekjen e babait të tij. Ankuesi po ashtu thekson se ai nuk ishte informuar nëse ishte zbatuar ndonjë hetim dhe cili ishte rezultati i tij.

36. Sa i përket pranueshmërisë, PSSP-ja parashtroi një sërë argumentesh. Dy prej tyre u refuzuan nga Paneli në vendimin e tij për pranueshmërinë. Argumenti i parë kishte të bënte me mundësinë se mund të ishte zbatuar një hetim nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi (ICTY). Argumentet e PSSP-së ishin të bazuara në një numër reference të ICTY për raportin e autopsisë. Mirëpo, në mungesë të ndonjë dëshmie tjetër për të mbështetur këtë qëndrim, Paneli e konsideroi të pamjaftueshme për të heq obligimin procedural të UNMIK-ut sipas nenit 2 dhe këtë argument e hodhi poshtë (shih HRAP, *B.A.*, vendim i 21 tetorit 2010, §§ 8 dhe 15-17).

37. Argumenti i dytë kishte të bënte me mundësinë që lëndimet vdekjeprurëse që i kishte marrë M.A. ishin të një natyre jo-penale. Prandaj, PSSP-ja parashtroi që në mungesë të një kërkese për zbatim të hetimeve drejtuar autoriteteve nuk do të mund të kishte obligim "automatik" për të hetuar rrethanat e vdekjes, d.m.th. nuk do të paraqitej obligimi procedural sipas nenit 2 të KEDNJ. PSSP-ja gjithashtu theksoi se ishte normale që rastet e tilla sikurse ky i M.A. "nuk konsideroheshin prioritet."Paneli e refuzoi këtë argument dhe thekso se një natyrë e mundshme "aksidentale" e traumës që shkaktoi vdekjen e M.A. nuk e shfajëson UNMIK-un nga përgjegjësia për të hetuar zhdukjen dhe vdekjen (shih *B.A.*, të cituar lart, në §§ 18-19).

38. PSSP-ja gjithashtu argumenton se në përgjithësi, kur të gjykon nëse UNMIK-u e ka përmbushur obligimin e vet procedural sipas nenit 2 të KEDNJ, Paneli duhet të marrë parasysh rrethanat e veçanta në Kosovë në atë kohë. Kjo veçanërisht vlen për periudhën fillestare të vendosjes së UNMIK-ut, periudhë kjo gjatë së cilës ka ndodhur zhdukja dhe vdekja e M.A.

39. PSSP-ja gjithashtu thekson se policia ndërkombëtare e UNMIK-ut ishte e ngadalshme gjatë pozicionimit të saj dhe se kah mesi i shtatorit 1999, kishte vetëm rreth 1,100 zyrtarë policorë ndërkombëtarë në mbarë Kosovën dhe se një strukturë e plotë e

policisë, duke përfshirë edhe sistemin e njësive për hetime penale në mbarë Kosovën, akoma nuk ishte themeluar. Kjo gjithashtu ishte koha kur shkalla e kriminalitetit në Kosovë ishte në nivelin më të lartë; Policia e UNMIK-ut pranonte me qindra raporte të zhdukjeve dhe vrasjeve, që e vështirësoi sigurimin e përpjekjeve të nevojshme hetimore pa resurset nevojshme.

40. Përveç kësaj, PSSP-ja kërkon nga Paneli të marrë parasysh faktorë të tjerë që lidhen me administrimin e operacioneve paqeruajtëse të KB-së, që për UNMIK-un ishin të jashtëm dhe jashtë kontrollit të tij, por që seriozisht kishin ndikuar të aftësinë e tij që të zbatojë hetime efikase. UNMIK-u nuk kishte kontroll mbi rekrutimin apo përzgjedhjen e zyrtarëve policorë ndërkombëtarë të cilët dërgoheshin nga shtetet anëtare të KB-së, zyrtarët policorë i nënshtroheshin rotacionit të rregullt, me funksione që zgjasnin nga gjashtë muaj deri më dy vite, dhe KB-ja nuk kishte forcë të qëndrueshme policore.

41. Sa i përket këtij rasti të caktuar, PSSP-ja në veçanti argumenton se ka pasur shumë pak dëshmi për Policinë e UNMIK-ut që të zbatojë një hetim për vdekjen e viktimës dhe se akoma ekzistojnë paqartësi nëse rasti u është raportuar autoriteteve. Për këtë arsye, rastet sikurse ai i M.A. nuk u konsideruan si prioritet.

42. PSSP-ja përfundimisht argumenton se "standardet e caktuara me KEDNJ për një hetim efikas nuk mund të jenë të njëjta për UNMIK-un sikurse për një shtet me organe policore funksionale dhe të mirë-organizuara, dhe me zyrtarë policorë që vet mund t'i rekrutojë, përzgjedhë dhe trajnojë." PSSP-ja konkludon se, duke marrë parasysh realitetin praktik të hetimeve policore, veçanërisht gjatë fazës së parë të misionit, mungesa e detajeve lidhur me rrethanat e vdekjes së M.A., mungesa e informacioneve të mëtejshme, e deklaratave të udhëheqësve apo dëshmitarëve, është e kuptueshme që UNMIK-u nuk ka mundur të jetë i suksesshëm në asnjë hetim për këtë rast të caktuar.

43. Sa u përket argumenteve të tjera të PSSP-së (§§ 38-42), Paneli vendosi t'i bashkojë ato në bazueshmërinë e ankesës.

44. Palët nuk kanë bërë komente shtesë as nuk kanë paraqitur argumente të reja në fazën e shqyrtimit të bazueshmërisë.

2. Vlerësimi i Panelit

a) Parashtrimi i dosjeve relevante

45. Siç u theksua më lart (shih § 25), UNMIK-u nuk ishte në gjendje që Panelit t'i sigurojë dosje që lidhen me hetimin e zhdukjes dhe vdekjes së M.A.

46. Paneli thekson se në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 thuhet se Paneli mund të kërkojë nga UNMIK-u parashtrimin e çfarëdo dokumentesh, dhe se PSSP-ja do të bashkëpunojë me Panelin dhe ofrojë ndihmën e nevojshme duke përfshirë, në veçanti, lëshimin e dokumenteve dhe informacioneve relevante për ankuesin. Në këtë aspekt Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut se konkluzionet do të nxirren nga sjellja e palës së paditur gjatë procedurës, duke përfshirë edhe dështimet e palës "për të paraqitur informacione në posedim të saj pa dhënë shënime të mjaftueshme" (shih GJEDNJ, *Çelikbilek kundër Turqisë*, nr. 27693/95, aktgjykim i 31 majit 2005, § 56). Mirëpo, përkundër një numër kërkesash nga Paneli, UNMIK-u nuk i ka siguruar Panelit asnjë dokument për hetime që i përket hetimit për zhdukjen dhe vdekjen e M.A.

47. Paneli po ashtu thekson se mirëmbajtja e duhur e dosjeve hetimore lidhur me krimet siç janë vrasjet dhe zhdukjet, nga hapja e hetimeve deri tek dorëzimi i tyre është kruciale për vazhdimin e hetimeve të tilla, dhe dështimi për ta bërë këtë vetvetiu mund të ngritë çështjet nën nenin 2. Paneli po ashtu thekson se UNMIK-u nuk ka dhënë sqarime për mungesën e ndonjë dokumentacioni.

48. Paneli nuk ka arsye të dyshojë se UNMIK-u ka bërë të gjitha përpjekjet për të marrë dosjet e hetimeve relevante. Mirëpo, përkundër kohës së mjaftueshme që i është dhënë UNMIK-ut për këtë qëllim (më shumë se dy vite), Panelit nuk i janë prezantuar as dosjet as ndonjë shpjegim i mundshëm për mungesën e tyre të plotë. Prandaj, Paneli nuk ka orientim për ndërmarrjen e ndonjë veprimi përveç se të vazhdojë me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës në bazë të dokumentacionit të siguruar nga ankuesi dhe informacionet e pakta që i ka siguruar UNMIK-u, dhe të nxjerrë konkludime nga kjo situatë (në këtë kuptim, shih GJEDNJ, *Tsechoyev kundër Rusisë*, nr. 39358/05, aktgjykim i 15 marsit 2011, § 146).

b) Parimet e përgjithshme lidhur me obligimin për zbatimin e një hetimi efikas sipas nenit 2

49. Së pari, Paneli konsideron se mungesa e dosjeve hetimore ngrit çështjen e barrës së dështmisë. Në këtë aspekt, për këtë çështje Paneli i referohet qasjes së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ). Rregulla e përgjithshme është se pala e cila kërkon paraqitjen e fakteve duhet t'i dëshmojë ato, por kjo nuk është rregull rigide.

50. Sipas kësaj rregulle të përgjithshme, në fazën e pranueshmërisë aplikanti duhet të paraqesë fakte, të cilat mbështesin pohimet e përgjegjësisë së shtetit, d.m.th. të ngrit një rast në shikim të parë kundër autoriteteve (shih përshtatshmërisht (*mutatis mutandis)* GJEDNJ, *Artico kundër Italisë*, nr. 6694/74, aktgjykim i 13 majit 1980, §§ 29-30, Seria A nr. 37; GJEDNJ, *Toğcu kundër Turqisë*, nr. 27601/95, aktgjykim i 31 majit 2005, § 95). Mirëpo, Gjykata Evropiane gjithashtu konsideron se "... kur ngjarjet në fjalë janë tërësisht apo në pjesën më të madhe ekskluzivisht në dijeni të autoriteteve … Barra e dëshmisë atëherë konsiderohet se është tek autoritetet për të siguruar shpjegim të mjaftueshëm dhe bindës" (shih GJEDNJ], *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar lart në § 33, në §§ 183-184).

51. Gjykata Evropiane po ashtu thekson se "... Qeverisë i takon qoftë të argumentojë në mënyrë bindëse pse dokumentacioni në fjalë nuk mund të shërbejë për konfirmimin e pohimeve të bëra nga aplikantët ose të sigurojë shpjegim të mjaftueshëm dhe bindës se si kanë ndodhur ngjarjet në fjalë, dështimi i të cilave ngrit çështjen sipas nenit 2 dhe/ose nenit 3 të Konventës" (shih GJEDNJ, *Akkum dhe të Tjerët kundër Turqisë*, nr.

21894/93, aktgjykim i 24 qershorit 2005, § 211, KEDNJ 2005-II (ekstrakte)). Gjykata shton se "… [nëse autoritetet] nuk i zbulojnë dokumentet kruciale për t'i mundësuar Gjykatës të vërtetojë faktet ose përndryshe të sigurojë shpjegim të mjaftueshëm dhe bindës, mund të nxirren konkludime të fuqishme " (shih GJEDNJ, *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar lart, në § 184; shih gjithashtu, HRC, *Benaniza kundër Algjerisë*, Opinione të 26 korrikut 2010, § 9.4, CCPR/C/99/D/1588/2007; HRC, *Bashasha kundër Libyan Arab Jamahiriya*, Opinione të 20 tetorit 2010, § 7.2, CCPR/C/100/D/1776/2008).

52. Paneli e kupton se drejtësia ndërkombëtare është zhvilluar në kontekstin kur qeveria në fjalë mund të jetë e përfshirë në pohime esenciale, që në këtë rast nuk vlen për UNMIK-un. Megjithatë, Paneli konsideron se meqë dokumentacioni ishte nën kontrollin ekskluziv të autoriteteve të UNMIK-ut, së paku deri në dorëzimin e tij EULEX-it, vlen parimi që "konkluzione të fuqishme" mund të nxirren për shkak të mungesës së dokumentacionit.

53. E dyta, Paneli thekson se obligimi pozitiv për hetimin e zhdukjeve është gjerësisht i pranuar në Ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut së paku nga rasti i Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut (GJNADNJ) *Velásquez-Rodríguez* (shih GJNADNJ, *Velásquez-Rodríguez kundër Honduras*, aktgjykim i 29 korrikut 1988, Seria C nr. 4). Obligimi pozitiv është theksuar edhe nga KDNJ që buron nga neni 6 (e drejta për jetë), neni 7 (ndalimi i trajtimit mizor dhe johuman) dhe neni 9 (e drejta për liri dhe siguri të personit), në lidhje me nenin 2(3) (e drejta për mjet të efektshëm) e KNDCP (shih KDNJ, Koment i Përgjithshëm nr. 6, 30 prill 1982, § 4; KDNJ, Koment i Përgjithshëm nr. 31, 26 maj 2004, §§ 8 dhe 18, KNDCP/C/21/Rev.1/Add. 13; shih gjithashtu, në mes tjerash, KDNJ, *Mohamed El AËani, kundër Libyan Arab Jamahiriya*, komunikimi nr. 1295/2004, Opinione të 11 korrikut 2007, KNDCP/C/90/D/1295/2004). Obligimi për të hetuar zhdukjet dhe vrasjet është gjithashtu i paraparë në Deklaratën e KB-së për mbrojtjen e të gjitha personave nga zhdukjet e detyrueshme (A/Res/47/133, 18 dhjetor 1992), dhe që më tutje është detajuar në udhëzimet e KB-së siç janë Manuali i KB-së për parandalimin dhe hetimin e efektshëm të ekzekutimeve të jashtëligjshme, arbitrare dhe pa procedurë gjyqësore (1991) dhe "Udhëzimet për zbatimin e hetimeve nga Kombet e Bashkuara për pohimet e masakrave" (1995). Rëndësia e këtij obligimi është konfirmuar me miratimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukjet e Detyrueshme në vitin 2006, e cila hyri në fuqi më 23 dhjetor 2010.

54. Për trajtimin e pohimeve të ankuesit, Paneli i referohet, në veçanti, praktikës së rrënjosur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për obligimin procedural sipas nenit 2 të KEDNJ. Gjykata konstaton se "obligimi për të mbrojtur të drejtën për jetë sipas nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin e përgjithshëm të shtetit sipas nenit 1 të Konventës për t'u "siguruar të gjithëve në kuadër të juridiksionit të tij të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë", nënkupton kërkesën se duhet të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv kur kemi raste të vrasjes së personave (shih përshtatshmërisht (*mutatis mutandis)*, GJEDNJ, *McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 27 shtatorit 1995, § 161, Seria A nr. 324; dhe GJEDNJ, *Kaya kundër Turqisë*, aktgjykim i 19 shkurtit 1998, § 105, Raporte 1998-I; shih gjithashtu GJEDNJ, *Jasinskis kundër Letonisë*, nr. 45744/08, aktgjykim i 21

dhjetorit 2010, § 71). Detyrimi për zbatimin e një hetimi të tillë ekziston për të gjitha rastet e vrasjeve dhe vdekjeve të tjera të dyshimta, qofshin kryerësit persona privat ose agjentë shtetërorë apo perona të panjohur (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgaris*, nr. 1108/02, aktgjykim i 5 nëntorit 2009, § 191).

55. Gjykata Evropiane po ashtu ka theksuar se obligimi procedural për të siguruar ndonjë formë të hetimit zyrtar efektiv ekziston edhe kur individi zhduket në rrethana kërcënuese për jetën dhe nuk kufizohet për rastet kur është e qartë se zhdukja ishte shkaktuar nga një agjent i shtetit (shih GJEDNJ), *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 33 lart, në § 136).

56. Autoritetet duhet të veprojnë me propozimin e tyre pasi ata të kenë mësuar për rastin, ata nuk mund t'ia lënë iniciativës së të afërmit që të parashtrojnë ankesë formale apo të marrin përgjegjësinë për zbatimin e ndonjë procedure hetimore (shih GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë* nr. 21689/93, aktgjykim i 6 prillit 2004, § 310; shih gjithashtu GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, nr. 57950/00, aktgjykim i 24 shkurtit 2005, § 210).

57. Në caktimin e standardeve të një hetimi efektiv, Gjykata ka theksuar se "përveç se duhet të jetë i pavarur, i qasshëm për familjen e viktimës, i kryer me përpikërinë dhe shpejtësinë e arsyeshme, të sigurojë një element të mjaftueshëm të vështrimit hetues të hapur të hetimit dhe rezultateve të tij, hetimi duhet gjithashtu të jetë efektiv në kuptimin që të jetë në gjendje të shpie në vendimin nëse vdekja ishte shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe nëse po, të shpie në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ [DHC], *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 33 lart, në § 191; shih gjithashtu GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, aktgjykim i 15 shkurtit 2011, § 63). Ky nuk është obligim për rezultate por për mjete. Autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapash të arsyeshëm që ata munden për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duk përfshirë, në mes tjerash dëshmi të dëshmitarëve okularë, dëshmi të analizave mjeko-ligjore dhe, kur është e mundshme, autopsinë e cila siguron të dhënat komplete dhe të sakta të lëndimit dhe një analizë objektive të të gjeturave klinike, duke përfshirë edhe shkakun e vdekjes. Çfarëdo e mete në hetim që pamundëson konstatimin e shkakut të vdekjes apo gjetjen e personit apo personave përgjegjës rrezikon rënien në konflikt me këtë standard (shih GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 56 lart, në § 312; dhe *Isayeva kundër Rusisë*, cituar në § 56 lart, në § 212).

58. Në veçanti, konkludimi i hetimit duhet të bazohet në analiza të plota, objektive dhe të paanshmet të të gjitha elementeve relevante. Dështimi i përcjelljes së një piste të qartë të hetimit pengon më masë shumë të madhe hetimin në konstatimin e rrethanave të rastit dhe në identifikimin e atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, cituar në § 54 lart, në § 201). Megjithatë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit hetues që përmbush pragun minimal të efektivitetit të hetimit varet nga rrethanat e rastit të caktuar. Ata duhet të vlerësohen në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe në lidhje me faktet praktike të punës hetimore (shih GJEDNJ, *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, aktgjykim i 1 dhjetorit 2009, § 105).

59. Veçanërisht, kur kemi të bëjmë me persona të zhdukur dhe më vonë të gjetur të vdekur, Gjykata ka deklaruar se procedurat e zhvarrosjes dhe identifikimit të mbetjeve mortore nuk e shterin obligimin sipas nenit 2 të KEDNJ. Gjykata konsideron se "obligimi procedural që del nga zhdukja e personit përgjithësisht do të qëndrojë derisa nuk zbulohet vendndodhja dhe fati i personit, dhe prandaj ka natyrën e vazhdimësisë" (GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, cituar në § 57 lart, në § 46; në kuptim të njëjtë GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 33 lart, në § 148, *Aslakhanova dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 2944/06 dhe të tjerë, aktgjykim i 18 dhjetorit 2012, § 122). Mirëpo, Gjykata po ashtu potencon se ky obligim procedural "nuk përfundon as pas zbulimit të trupit .... Kjo vetëm hedh dritë në një aspekt të fatit të personit të zhdukur, dhe obligimin për të zbardhur zhdukjen dhe vdekjen, si dhe identifikimin dhe ndjekjen penale të kryerësve të akteve të paligjshme në lidhje me këtë në përgjithësi do të qëndrojnë" (GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, cituar lart, në § 46; në kuptim të njëjtë GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 33 lart, në § 145). Derisa gjetja dhe identifikimi pasues i mbetjeve mortore të viktimës në vetvete mund të jenë të arritura të rëndësishme, obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të ekzistojë (shih GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, cituar lart, në § 64).

60. Lidhur me kushtin për vështrim hetues të hapur, Gjykata gjithashtu ka deklaruar se duhet të ekzistojë një element i mjaftueshëm i shqyrtimit të hapur të hetimit apo rezultateve të tij për të siguruar përgjegjësinë në aspektin praktik dhe teorik. Shkalla e kërkuar e hetimit të hapur mund të ndryshojë nga rasti në rast. Mirëpo, në të gjitha rastet, i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë për aq sa është e nevojshme të mbrohen interesat e tij legjitime (shih GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të Tjerët*, cituar në § 56 lart, në §§ 311-314; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, cituar në § 56 lart, në §§ 211-214 dhe rastet e cituara aty; GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 7 korrikut 2011, nr. 55721/07, § 167, KEDNJ 2011).

c) Zbatimi i nenit 2 në kontekstin e Kosovës

61. Paneli është i vetëdijshëm se zhdukja dhe vdekja e M.A. ndodhi menjëherë pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë, në pasojat imediate të konfliktit të armatosur, kur krimi, dhuna dhe pasiguria ishin të zakonshme.

62. PSSP-ja, nga ana e tij, nuk e kundërshton se UNMIK-u kishte detyrimin për të hetuar rastin në fjalë sipas nenit 2 të KEDNJ. Mirëpo, sipas PSSP-së, rrethanat unike që i përkasin kontekstit të Kosovës dhe vendosjes së UNMIK-ut në fazën e parë të misionit të tij duhet të merren parasysh kur të vlerësohet nëse ky hetim është në përputhje me nenin 2 të KEDNJ. Në esencë, PSSP-ja argumenton se nuk është e mundshme që për UNMIK-un të zbatohen standardet e njëjta sikurse për një shtet në situatë normale.

63. Paneli konsideron se argumentet e PSSP-së ngrenë dy çështje kryesore: së pari, nëse standardet e nenit 2 vazhdojnë të zbatohen në situata të konfliktit ose dhunës së përgjithësuar dhe, së dyti, nëse standardet e tilla do të konsiderohen plotësisht të zbatueshme për UNMIK-un, veçanërisht në fazën e parë të misionit të tij.

64. Sa i përket zbatimit të nenit 2 për UNMIK-un, Paneli përkujton se me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin të zbatojë standardet e të drejtave të njeriut të pranuara ndërkombëtarisht në ushtrimin e funksioneve të tij. Ndërmarrja e këtij obligimi u përcaktua detajisht në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999, me të cilën UNMIK-u mori obligime sipas instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe KEDNJ. Në këtë aspekt, Paneli tanimë ka konstatuar se është e vërtetë se karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e lidhura me të duhet të merren parasysh në një sërë situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si justifikim për uljen e standardeve për respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat janë inkorporuar me kohë në mandatin e UNMIK-ut (shih PKDNJ, *Milogoriç dhe të Tjerët*, nr. 38/08 dhe të tjerë, mendim i 24 marsit 2011, § 44; *Berisha dhe të Tjerët, nr.* 27/08 dhe të tjerë, mendim i 23 shkurtit 2011, § 25; *Laliç dhe të Tjerët*, nr. 09/08 dhe të tjerë, mendim i 9 qershorit 2012, § 22).
65. Sa i përket zbatimit të nenit 2 në situatën e konfliktit ose dhunës së përgjithësuar, Paneli përkujton se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka përcaktuar zbatimin e nenit 2 për situatat pas konfliktit, duk përfshirë edhe shtetet e ish Jugosllavisë (shih, në mesin e shembujve të tjerë, GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, cituar në § 57 lart, dhe GJEDNJ, *Juliariç kundër Kroacisë*, nr. 20106/06, aktgjykim i 20 janarit 2011). Gjykata gjithashtu ka konsideruar se obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të zbatohet në "situata të vështira të sigurisë, duke përfshirë edhe kontekstin e konfliktit të armatosur" (shih GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar në § 60 lart, në § 164; shih gjithashtu GJEDNJ, *Güleç kundër Turqisë*, aktgjykim i 27 korrikut 1998, § 81, Raporte 1998-IV; GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, aktgjykim i 28 korrikut 1998, §§ 79 dhe 82, Raporte 1998-IV; GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar në § 56 lart, në §§ 85-90, 309-320 dhe 326-330; *Isayeva kundër Rusisë*, cituar në § 56 lart, në §§ 180 dhe 210; GJEDNJ, *Kanlibaş kundër Turqisë*, nr. 32444/96, aktgjykim i 8 dhjetorit 2005, §§ 39-51).

66. Gjykata ka pranuar se "kur vdekja [dhe zhdukjet] të cilat duhet hetuar sipas nenit 2 ndodhin në rrethana të dhunës së përgjithësuar, konfliktit të armatosur ose kryengritjes, gjatë hetimeve mund të ketë pengesa dhe shtrëngimet konkrete mund të detyrojnë përdorimin e masave hetimore më pak efektive ose mund të shkaktojnë vonesën e hetimit" (shih, GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, në §164; *GJEDNJ, Bazorkina kundër Rusisë*, nr. 69481/01, aktgjykim i 27 korrikut 2006, § 121). Megjithatë, Gjykata ka konsideruar se "obligimi sipas nenit 2 për të mbrojtur jetën detyron që, edhe në kushte të vështira të sigurisë, duhet ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar zbatimin e një hetimi efektiv dhe të pavarur për shkeljet e pohuara të së drejtës për jetë (shih, në mesin e shumë shembujve të tjerë, GJEDNJ, *Kaya kundër Turqisë*, cituar në § 54 ;lart, në §§ 86-92; GJEDNJ, *Ergi*, cituar lart §§ 82-85; GJEDNJ [DHL], *Tanrıkulu kundër Turqisë*, nr. 23763/94, aktgjykim i 8 korrikut 1999, §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; GJEDNJ, *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, nr. 57942/00 dhe 57945/00, aktgjykim i 24 shkurtit 2005, §§ 156-166; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, cituar në § 56 lart, në §§ 215-224; GJEDNJ, *Musayev dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 57941/00 dhe të tjerë, aktgjykim i 26 korrikut 2007, §§ 158-165).

67. Në mënyrë të ngjashme, KDNJ konsideron se e drejta për jetë, duke përfshirë edhe garancitë e saj procedurale, konsiderohet si e drejtë supreme nga e cila nuk lejohet asnjë lloj privimi edhe në kohë të emergjencave publike që kërcënojnë jetën e kombit (shih, KDNJ, Koment i Përgjithshëm nr. 6, cituar në § 53 lart, në § 1; KDNJ, *Abubakar Amirov dhe Aïzan Amirova kundër Federatës Ruse*, komunikata me nr. 1447/2006, mendime të 22 prillit 2009, § 11.2, CCPR/C/95/D/1447/2006). Gjithashtu, KDNJ ka theksuar zbatimin e nenit 2 (3), 6 dhe 7 të **KNDCP** duke ju referuar në mënyrë specifike obligimit të UNMIK-ut për të zbatuar hetime të duhura për zhdukjet dhe rrëmbimet në Kosovë (shih KDNJ, Vërejtje përmbyllëse të Komitetit për të Drejtat e Njeriut: Kosovë (Serbi), 14 gusht 2006, §§ 12-13, CCPR/C/UNK/CO/1).

68. Paneli merr parasysh vështirësitë me të cilat u përball UNMIK-u gjatë fazës së parë të vendosjes së tij. Paneli thekson se dhënia e rëndësisë së duhur çështjes së personave të zhdukur në Kosovë nënkuptonte që UNMIK-u, duhej të merrte parasysh dimensionin humanitar dhe atë penal të situatës. Në veçanti, Paneli konsideron se rëndësia që u është dhënë hetimeve penale dhe vështirësitë në Kosovë që kufizuan aftësitë e autoriteteve hetimore në zbatimin e hetimeve të tilla, siç është përshkruar nga PSSP-ja, ishin vendimtare që UNMIK-u nga fillimi të krijojë një ambient të favorshëm për kryerjen e hetimeve të kuptimshme. Kjo do të përfshinte vendosjen e një sistemi që do të përfshinte elemente të tilla si ndarja e përgjegjësive të përgjithshme për mbikëqyrjen dhe monitorimin e progresit të bërë në hetime, sigurimin e një rishikimi të rregullt të gjendjes së hetimeve, dhe një proces për dorëzimin e duhur të rasteve ndërmjet zyrtarëve apo njësive të ndryshme të Policisë së UNMIK-ut. Sistemi i tillë duhet gjithashtu të marrë parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve (shih, përshtatshmërisht (*mutatis mutandis)*, GJEDNJ, *R.R. dhe të Tjerët kundër Hungarisë*, nr. 19400/11, aktgjykim i 4 dhjetorit 2012, §§ 28-32), si dhe të marrë në konsideratë ndjeshmërinë speciale të personave të zhdukur në situatat pas konfliktit (shih GJEDNJ [DHL], *Sargsyan kundër Azerbejxhanit*, nr. 40167/06, vendim i 14 dhjetorit 2011, § 145; dhe GJEDNJ [DHL], *Chiragov dhe të Tjerët kundër Armenisë*, nr. 13216/05, vendim i 14 dhjetorit 2011, § 146). Derisa është e kuptueshme që vendosja dhe organizimi i organeve të policisë dhe drejtësisë ndodhën gradualisht, Paneli gjykon se ky proces u kompletua në vitin 2003, kur sistemi i policisë dhe i drejtësisë në Kosovë u cilësuan të jenë sisteme që "funksionojnë mirë" dhe janë "të qëndrueshme" nga Sekretari i Përgjithshëm i KB-së (shih § 16 lart).

69. Paneli po ashtu thekson se detyra e tij nuk është të rishikojë praktikat përkatëse apo pengesat e pohuara në zbatimin e hetimeve efikase nga pikëvështrimi abstrakt, por vetëm në relacion me zbatimin e tyre specifik në rrethanat e caktuara të një rasti për të cilin është parashtruar ankesë pranë tij (shih, GJEDNJ, *Brogan dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 29 nëntorit 1988, § 53, Seria A nr. 145-B). Kështu që, Paneli pajtohet me PSSP-në se natyra dhe shkalla e vështrimit hetues për të përcaktuar nëse efekti i hetimeve përmbush pragun minimal varet nga rrethanat e rastit të caktuar. Për këto arsye, Paneli konsideron se do të gjykojë për çdo rast nëse janë marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për zbatimin e një hetimi efikas ashtu siç përcaktohet me nenin 2, duke marrë parasysh realitetin e punës hetimore në Kosovë.

d) Plotësimi i kushtit të nenit 2 në rastin aktual

70. Duke ju kthyer rrethanave të rastit në fjalë, Paneli së pari trajton çështjen e barrës së dëshmisë. Në fazën e pranueshmërisë, Paneli ishte i kënaqur se pohimet e ankuesit nuk ishin të pabazuara, kështu që Paneli pranoi ekzistimin e lëndës në shikim të parë: se M.A u zhduk në rrethana kërcënuese për jetën dhe se, më së voni më 13 nëntor 2000, UNMIK-u mësoi për rastin.

71. Në përputhje me këtë, duke zbatuar parimet e diskutuara më lart (shih §§ 49-50), Paneli konsideron se barra e dëshmisë është zhvendosur tek i padituri, që do të thotë se UNMIK-u duhet t'i paraqesë Panelit dëshmi për një hetim adekuat si mbrojtje kundër pohimeve të parashtruara nga ankuesi dhe të miratuara nga Paneli si të pranueshme. UNMIK-u nuk është liruar nga obligimi i tij në këtë aspekt, meqë as nuk ka paraqitur ndonjë dosje hetimore as nuk e ka sqaruar dështimin e tij për ta bërë këtë në mënyrë "të kënaqshme dhe bindëse". Në përputhje me këtë, Paneli do të nxjerrë konkluzionet nga kjo situatë.

72. Paneli thekson se sipas Raportit vjetor të Policisë së UNMIK-ut të vitit 2000, së paku nga mesi i shtatorit 1999, i tërë sistemi i hetimeve penale në rajonin e Prishtinës ishte nën kontrollin e plotë të UNMIK-ut. Prandaj, ishte përgjegjësi e UNMIK-ut të sigurojë, *së pari*, që hetimi të zbatohet në mënyrë të shpejtë dhe efikase; *së dyti*, që të gjitha materialet relevante hetimore t'u dorëzohen në mënyrën e duhur autoriteteve që marrin përsipër përgjegjësinë për hetimin (EULEX, shih § 18 lart); dhe *së treti*, se dosjet hetimore mund të gjenden dhe rimerren, nëse paraqitet nevoja në një fazë të mëvonshme.

73. Nga mungesa e ndonjë dosje hetimore, Paneli konkludon se ka ndodhur njëra nga situatat vijuese: nuk është bërë hetim; UNMIK-u qëllimisht zgjodhi opsionin që Panelit të mos ia paraqesë dosjen, përkundër obligimit të tij për të bashkëpunuar me Panelin dhe për t'i siguruar atij ndihmën e nevojshme, duke përfshirë edhe lëshimin e dokumenteve relevante për ankesat sipas nenit 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (cituar në § 31 lart); dosja nuk i është dorëzuar EULEX-it në mënyrën e duhur; ose UNMIK-u dështoi në rimarrjen e dosjes nga kujdestari aktual.

74. Paneli tanimë veç e ka cekur lart se nuk ka arsye të dyshojë në sinqeritetin e UNMIK-ut për të siguruar dosjen penale për t'u rishqyrtuar nga Paneli. Mirëpo, Paneli konsideron se cilido shpjegim i mundshëm që vlen, ai prapë se prapë tregon një dështim, për të cilin drejtpërsëdrejti ngarkohet UNMIK-u, qoftë në kohën kur ka ushtruar funksionet e veta ekzekutive apo në kapacitetin e tij aktual.

75. Duke shqyrtuar veçantitë e këtij rasti, Paneli bën me dije se ka pasur të meta të qarta në zbatimin e hetimeve nga fillimi, duke pasur parasysh se faza fillestare e një hetimi është i një rëndësie shumë të madhe. Mirëpo, duke pasur parasysh rrethanat e paraqitura lart lidhur me juridiksionin e tij të kufizuar kohor (shih § 33), Paneli përkujton se ka kompetencë kohore (*ratione temporis)* për të vlerësuar përputhshmërinë e hetimit me nenin 2 të KEDNJ vetëm për periudhën pas 23 prillit 2005, duke marrë parasysh gjendjen e rastit në atë datë (GJEDNJ, *Paliç kundër*

Bosnjës dhe Hercegovinës, cituar në § 57 lart, në § 70). Periudha nën shqyrtim përfundon më 9 dhjetor 2008, me marrjen e përgjegjësive në fushën e administrimit të drejtësisë nga EULEX-i (shih § 18 lart).

76. Paneli thekson se nga momenti kur UNMIK-u mësoi për rastin deri më 23 prill 2005, veprimet e vetme të ndërmarra nga UNMIK-u lidhen me zhvarrosjen, identifikimin dhe dorëzimin e mbetjeve mortore të M.A., që ndodhën ndërmjet qershorit dhe nëntorit 2000. Edhe pse kjo në vetvete mund të konsiderohet si e arritur e rëndësishme, Paneli përkujton se obligimi procedural sipas nenit 2 nuk përfundoi me zbulimin e trupit, veçanërisht pasi tregoi shenja të një vdekje të mundshme të dhunshme. Megjithatë, nuk ka dëshmi se janë ndërmarrë veprime lidhur me sqarimin e rrethanave të zhdukjes dhe vdekjes së M.A.

77. Në veçanti, nuk ka indikacione se Policia e UNMIK-ut ndërmori në këtë aspekt hapa hetimor siç janë: marrjen e ankuesit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes në pyetje, marrjen në pyetje e dëshmitarëve të mundshëm në mesin e fqinjëve, bastisja e pronës së viktimës ku ankuesit i kishin lajmëruar se ai ishte vrarë, bastisja e lokacionit ku trupi i tij ishte gjetur fillimisht, përpilimi i një liste të gjësendeve që kanë mundur të mungojnë në shtëpi, përpjekja për të identifikuar dhe gjetur personin i cili e kishte njoftuar ankuesin për vdekjen e babait të tij.

78. Duke ju referuar periudhës në kuadër të juridiksionit të tij, me fillim nga 23 prilli 2005, Paneli thekson se nuk ka dëshmi se janë ndërmarrë hapat themelorë hetimor, siç janë marrja në pyetje e ankuesit dhe dëshmitarëve të mundshëm për cilindo rrëmbim që mund të kishte ndodhur. Pas kësaj date kritike, dështimi në zbatimin e veprimeve të nevojshme hetimore vazhdoi, duke çuar kështu, në pajtim me obligimin e vazhdueshëm për hetim (shih § 59 lart), vlerësimin e tërë hetimit në kuadër të periudhës së juridiksionit të Panelit.

79. Përveç kësaj, Paneli konsideron se, meqë ata të cilët ishin përgjegjës për krimin nuk ishin gjetur, UNMIK-u ishte i obliguar të përdorte mjetet në dispozicion për të rishikuar rregullisht progresin e hetimit, për të siguruar që asgjë nuk ishte anashkaluar dhe se çfarëdo dëshmish të reja ishin marrë në konsideratë, si dhe të njoftonte të afërmit e M. A. lidhur me pista të reja të mundshme të hetimit. Mirëpo, nuk ka indikacione se janë bërë rishikime të tilla ndonjëherë.

80. Mungesa e qartë e ndonjë reagimi adekuat nga Policia e UNMIK-ut mund të ketë bartur në mënyrë indirekte tek kryerësit idenë se, autoritetet ose nuk ishin të aftë ose nuk kishin vullnetin të hetojnë aktet e tilla kriminale. Një qëndrim i tillë i autoriteteve ndaj krimeve më të rënda në çdo shoqëri, dhe veçanërisht në rrethana pas konfliktit, pashmangshëm krijon kulturën e pandëshkueshmërisë në mesin e kriminelëve, dhe mund të shpie vetëm në përkeqësimin e situatës. Problemet me të cilat ishte përballur UNMIK-u në fillim të misionit të tij, të cilat u diskutuan lart, nuk e arsyetojnë një mosveprim të tillë, qoftë në fillim apo më vonë.

81. Sa i përket deklaratës së PSSP-së se rastet e tilla si M.A. “nuk konsideroheshin prioritet,” Paneli pajtohet se në një situatë ku kemi fluks masiv të kallëzimeve të

mundshme penale dhe kapacitete të kufizuara të hetimeve policore në terren, prioritizimi është njëra prej mënyrave për ruajtjen e nivelit të efikasitetit, ku trajtohen vetëm rastet më të rënda me pista të qarta të hetimit. Në këtë aspekt, Paneli konsideron superioritetin e të drejtës për jetë në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (shih, p.sh., GJEDNJ, *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë* [DHL], nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, aktgjykim i 22 marsit 2001, § 85, KEDNJ 2001-II). Sido që të jetë, kategorizimi i tillë i një hetimi duhet bërë vetëm pasi të jenë ndërmarrë veprimet minimale hetimore të mundshme dhe të jenë mbledhur dhe analizuar informacionet e arritshme. Në këtë rast, nuk është dashur të bëhet prioritizimi kur nuk ishin mbledhur informacione mbi rrethanat e vdekjes, veçanërisht pasi kishte ndodhur në një ambient të qartë me kërcënim për jetën dhe në rrethana të dyshimta.

82. Prandaj, Paneli konsideron se, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit të caktuar, nuk duket se janë ndërmarrë hapa nga UNMIK-u për të sqaruar rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së M.A. dhe sjelljen e kryerësve para drejtësisë. Në këtë kuptim Paneli gjykon se hetimi nuk ishte adekuat dhe se nuk e plotësoi kushtin e shprehjes së gatishmërisë, reagimit të shpejtë dhe efikas (shih § 57 lart), siç kërkohet me nenin 2.

83. Sa i përket kushtit për vështrim hetimor të hapur, Paneli përkujton se neni 2 gjithashtu kërkon përfshirjen e të afërmit të viktimës në procesin hetimor deri në masën sa është e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij legjitime. Në këtë aspekt, ankuesi pohon se asnjëherë nuk ishte njoftuar për hapat e ndërmarrë nga hetuesit. Paneli bën me dije se ankuesi vetëm kishte komunikuar me KFOR-in dhe vetëm për gjetjen, dorëzimin dhe varrimin e mbetjeve mortore të të atit të tij; komunikimi i fundit në këtë drejtim kishte ndodhur në nëntor 2000. Siç ka cekur tanimë Paneli, nga ankuesi asnjëherë nuk ishte marrë ndonjë deklaratë dhe atij nuk ju kishte siguruar asnjë informacion lidhur me gjendjen e hetimit.

84. Paneli e kupton pikëpamjen e ankuesit se sasia e informacioneve të pranuara nuk ishte e kënaqshme. Paneli është po ashtu i vetëdijshëm se në të gjitha rastet, i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë deri në shkallën e nevojshme për mbrojtjen e interesave të tij legjitime (shih GJEDNJ [DHL], *Tahsin Acar kundër Turqisë nr*. 26307/95, aktgjykim i 8 prillit 2004, § 226, KEDNJ 2004-III; GJEDNJ, *Taniş kundër Turqisë,* nr. 65899/01, aktgjykim i 2 gushtit 2005, § 204, KEDNJ 2005-VIII). Prandaj, Paneli konsideron se familja e ankuesit nuk kishte qasje në hetim ashtu siç kërkohet me nenin 2.

85. Duke marrë parasysh mungesat dhe të metat e përshkruara lart, Paneli konstaton se UNMIK-u dështoi në zbatimin e një hetimi adekuat dhe efektiv për zhdukjen dhe vdekjen e babait të ankuesit. Prandaj, ka pasur shkelje të nenit 2 të KEDNJ sipas obligimit të saj procedural.

C. Pohimi për shkelje të nenit 3 të KEDNJ

86. Ankuesi thekson se mungesa e informacioneve dhe pasiguria për zhdukjen dhe vdekjen e të atit i shkaktoi atij dhe familjes vuajte mentale. Ankuesi thirret në nenin 3 të KEDNJ që ndalon trajtimin johuman dhe degradues.

87. Në vendimin e tij të 21 tetorit 2010, sipas nenit 3 Paneli e shpalli ankesën të pranueshme. Megjithatë, Paneli duhet të rivlerësojë pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesës, duke marrë parasysh zhvillimet pasuese në praktikën gjyqësore të Panelit lidhur me pranueshmërinë e ankesave sipas nenit 3 të KEDNJ.

88. Në veçanti, Paneli thekson se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pjesëtari i familjes së personit të zhdukur nën kushte të caktuara mund të konsiderohet viktimë e trajtimit nga autoritetet në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ, që ndalon trajtimin johuman. Kur personi i zhdukur më vonë gjendet i vdekur, zbatimi i nenit 3 në parim është i kufizuar për periudhën e veçantë gjatë së cilës pjesëtari i familjes ka pasur pasiguri, vuajtje dhe ankth që i përket fenomenit specifik të zhdukjeve (shih, *p.sh*., GJEDNJ, *Luluyev dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 69480/01, aktgjykim i 9 nëntorit 2006, §§ 114-115, KEDNJ 2006-XIII (ekstrakte); GJEDNJ, *Gongadze kundër Ukrainës*, nr. 34056/02, aktgjykim i 8 nëntorit 2005, § 185, GJEDNJ 2005-XI).

89. Në këtë rast, periudha relevante zgjati deri më 13 nëntor 2000 kur mbetjet mortore të M.A. ju dorëzuan ankuesit.

90. Paneli tanimë ka përkujtuar se, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion vetëm për "ankesat lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që kishin ndodhur jo më herët se 23 prill 2005, apo që dalin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date kur faktet e tilla paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut".

91. Paneli nuk ka dyshime për dhimbjet e thella që i janë shkaktuar ankuesit nga zhdukja dhe vdekja e të atit të tij. Megjithatë, Paneli duhet të konkludojë se kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të tij (*ratione temporis)* (shih PKDNJ, *Patrnogiç*, nr. 252/09, vendim i 16 dhjetorit 2011, §§ 16-20; PKDNJ, *S.C.*, nr. 02/09, mendim i 8 janarit 2012, §§ 103-109) dhe për këtë arsye shpallet e papranueshme.

V. KOMENTET DHE REKOMANDIMET PËRFUNDIMTARE

92. Duke marrë parasysh të gjeturat e Panelit në këtë rast, Paneli është i mendimit se ndonjë formë e kompensimit është e nevojshme.

93. Paneli thekson se zhdukjet e detyrueshme dhe vrasjet arbitrare përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, të cilat autoritetet kompetente janë të obliguar t'i hetojnë dhe kryerësit t'i sjellin para drejtësisë në të gjitha rrethanat. Paneli po ashtu thekson se në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999), UNMIK-u nga 1999 deri më 2008 kishte përgjegjësinë primare për të hetuar efektivisht dhe ndjekur penalisht zhdukjen dhe vdekjen e M.A., dhe dështimi i UNMIK-ut për ta bërë këtë përbën një shkelje tjetër të rëndë të të drejtave të njeriut të viktimës dhe të afërmit të tij, në veçanti të drejtën për të marrë një vendim mbi të vërtetën e rastit.

94. Paneli thekson se shqetësimet e vetë PSSP-së se resurset joadekuate, veçanërisht në fillim të misionit të UNMIK-ut, e vështirësuan përmbushjen e obligimit të UNMIK-ut sa i përket të drejtave të njeriut.

95. Normalisht UNMIK-u është ai i cili duhet të ndërmerr hapat e duhur për t'i dhënë fund shkeljes së cekur dhe të kompensojë aq sa është e mundshme efektet e saj. Mirëpo, siç ka cekur Paneli lart (shih § 18) përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen e kontrollit të plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit nga EULEX-i. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozicion të merr masa të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në hetimet të cilat ende janë në pritje pranë EULEX-it ose autoriteteve lokale. Gjithashtu, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë më 17 shkurt 2008 dhe më vonë, dhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u pushoi së kryeri funksione ekzekutive në Kosovë, duke kufizuar ky fakt kompetencat e tij në sigurimin e reparacionit të plotë dhe efektiv për shkeljen e kryer, ashtu siç kërkohet me parimet e vendosura të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

96. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi për të kompensuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

Lidhur me ankuesin dhe rastin Paneli e konsideron të duhur që UNMIK-u:

- Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për situatat e juridiksionit të kufizuar të shtetit (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të Tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, aktgjykim i 8 korrikut 2004, § 333, KEDNJ 2004-VII; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, aktgjykim i 2 marsit 2010, § 171, KEDNJ 2010 (ekstrakte); GJEDNJ [DHL], *Catan dhe të Tjerët kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë* [DHL], nr. 43370/04 dhe të tjerë, aktgjykim i 19 tetorit 2012, § 109), duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion *vis-à-vis* EULEX-it dhe autoriteteve të Kosovës, të merr garanci se hetimet lidhur me rastin në fjalë do të vazhdojnë në pajtim me kushtet për një hetim efektiv ashtu siç parashihet me nenin 2, se rrethanat lidhur me zhdukjen dhe vdekjen e M.A. do të vërtetohen dhe se kryerësit do të sillen para drejtësisë; se ankuesi dhe i afërmi tjetër do të informohen për procedurat e tilla dhe dokumentet relevante atyre do t'u vihen në dispozicion, nëse është e nevojshme;

- Të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për dështimin e UNMIK-ut për të hetuar në mënyrë adekuate zhdukjen dhe vdekjen e M.A. dhe ankuesit dhe familjes së tij t'i kërkojë falje publike lidhur me këtë;

- Të ndërmerr hapa të duhur për t'i paguar ankuesit një kompensimi adekuat për dëmin moral që ai ka pasur për shkak të dështimit të UNMIK-ut në zbatimin e një hetimi efektiv siç u cek më lart.

Paneli po ashtu e konsideron të duhur që UNMIK-u:

- Në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së mbi "Parimet bazike dhe udhëzimet mbi të drejtën për kompensim dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare" (A/Res/60/147, 21 mars 2006), të ndërmerr hapat e duhur, përmes subjekteve të tjera të KB-së që veprojnë në Kosovë, organeve lokale dhe organizatave joqeveritare, për realizimin e një programi reparacioni të plotë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë kompensimin për vuajtjet, rehabilitimin, përmbushjen e kërkesave dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut nga të gjitha komunitetet, të cilat ndodhën gjatë dhe pas konfliktit të Kosovës;

- Të ndërmerr hapat përkatës para organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së, për ndarjen e resurseve adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar mbështetjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në të gjitha kohërat nga Kombet e Bashkuara, duke përfshirë edhe kohën e kryerjes së funksioneve administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe të pavarur.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT PROCEDURAL SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

2. **KONSTATON SE ANKESA SIPAS NENIT 3 ËSHTË E PARPANUESHME;**

3. **REKOMANDON QË UNMIK-U:**

a. **TË NXISË EULEX-IN DHE AUTORITETET TJERA KOMPETENTE NË KOSOVË QË TË NDËRMARRIN TË GJITHA HAPAT E MUNDSHËM PËR TË SIGURUAR VAZHDIMIN E HETIMIT PENAL PËR ZHDUKJEN DHE VDEKJEN E BABAIT TË ANKUESIT NË PAJTIM ME NENIN 2 TË KEDNJ DHE SJELLJEN E KRYERËSVE PARA DREJTËSIË;**

b. **TË PRANOJË PUBLIKISHT PËRGJEGJËSINË PËR DËSHTIMIN E TIJ NË ZBATIMIN E NJË HETIMI EFIKAS PËR ZHDUKJEN DHE VDEKJEN E BABAIT TË ANKUESIT DHE T'I KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESIT;**

c. **TË NDËRMERR HAPAT E DUHUR PËR PAGIMIN E KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESIT PËR DËMET MORALE;**

d. **TË NDËRMERR HAPAT PËRKATËS PËR REALIZIMIN E NJË PROGRAMI REPARACIONI TË PLOTË DHE GJITHËPËRFSHIRËS;**

e. **TË MDËRMERR HAPAT E DUHUR NË KOMBET E BASHKUARA SI GARANTUESE E MOSPËRSËRITJES;**

f. **TË NDËRMERR MASA IMEDIATE DHE EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME NË KËTË RAST.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar

Aneks

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

CCIU - NJQHP – Njësia Qendrore për Hetime Penale
DOJ – DD – Departamenti i Drejtësisë
DPPO - PPQ- Prokuroria Publike e Qarkut
ECHR - KEDNJ- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR - GJDNJ- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
EU – **BE** – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundimin e Ligjit
FRY – **RFJ –** Republika Federative e Jugosllavisë
GC - DHL- Dhoma e Lartë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
HRAP - PKDNJ- Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC – **KDNJ –** Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
IACtHR – **GJNADNJ-** Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
ICCPR – **KNDCP** – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
ICMP – **KNPZH** – Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur
ICRC – **KNKK-** Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
ICTY – **TNPIJ** – Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavi
KFOR – Forca e Sigurisë Ndërkombëtare (e njohur përgjithësisht si Forca e Kosovës)
KLA – **UÇK -** Ushtria Çlirimtare e Kosovës
MoU – MiM - Memorandum i Mirëkuptimit
MPU – NJPZH – Njësia për Persona të Zhdukur
NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OMPF – ZPZHML – Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore
OSCE – OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RIU – NJHR – Njësia Hetuese Rajonale
SRSG – PSSP- Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UN – KB- Kombet e Bashkuara
UNHCR – Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VRIC – **KIRV** – Komisioni për Identifikimin dhe Rehabilitimin e Viktimave
ËCIU – **NJHKL** – Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës